

PROGETTO ANCONAPACO



AT5

Per projektimin territorial e te vendeve per zhvillimin lokal me referimet te veçante per zonat jashte perimetrit urban dhe ato te ndervena

Nen kujdesin e
Giovanni Cafiero

Referenti shkencor
Prof. *Gianluigi Nigro*

Punimet per te marre pjese
**DREJT PREGATITJES SE PIKAVE TE UDHEHEQJES
PARIMET E PERGJITHSHME**

RRETHI MARCHE

PROJEKTI ANCONAPACO

(ANALIZA E KUSHTEVE TE PASURIVE NATYRORE, AMBIENTALE DHE E PEJSAZHIT TE ZONAVE KODRINORE, ULTESIRAVE E BREGDETIT)

**INICIATIVA E KOMUNITETIT NDER-QARKOR IIIA MIDIS KUFIJVE TE
ADRIATIKUT
REGIONE MARCHE – QARKU I DURRESIT**

AT5

Per projektimin territorial e te vendeve per zhvillimin lokal me referiment te veçante per zonat jashte perimetrit urban dhe ato te ndervena

Punimet per te marre pjese

**DREJT PREGATITJES SE PIKAVE TE UDHEHEQJES
PARIMET E PERGJITHSHME**

Nen kujdesin e Giovanni Cafiero

**Referenti shkencor: Prof. Gianluigi Nigro
Profesori Urbanistike
Universitet La Sapienza Roma
Fakultet i Arkitekture “Ludovico Quadroni”**

JANAR 2007

1	PJESA E PARE : PARIMET E PERGJITHSHME	3
1.1	PEJSAZHI SI PASURI	3
1.2	PEJSAZHI SI SHPREHJE E TERRITORIT	4
1.3	PEJSAZHI SI PRODHIM I BASHKEPUNIMIT TE NJERIUT ME AMBIENTIN	5
1.4	PEJSAZHI SI NJE PASURI PUBLIKE	6
1.5	PEJSAZHI DHE INSTITUCIONET	7
1.6	PEJSAZHI PJESEMARRES	9
1.7	POLITIKA KRIJUESE DHE E INTEGRUAR	10
1.8	TEKNIKAT DHE NIVELET E PLANIFIKIMIT	10
1.9	PROJEKTI I PEJSAZHIT PER TERRITORIN.....	12

1. PJESA E PARE : PARIMET E PERGJITHSHME

1.1 PEJSAZHI SI PASURI

Pejsazhi si pasuri

Per te percaktuar cilesine e pejsazhit si nje objektiv i interesit te pergjithshem duhet qe shoqeria civile dhe administrata publike para se gjithash te njohin karakterin e tij si pasuri strategjike kolektive.

Pejsazhi, duke qene nje bashkesi elementesh qe karakterizojne ambientin dhe qe mirepresin nje popullsi, eshte nje pasuri kolektive qe jep kontributin e saj ne percaktimin e cilesise se perceptimit dhe te funksionimit te hapësirave te jetes dhe te punes.

Pejsazhi eshte nje pasuri kolektive edhe sepse garanton mundesine e shkembimit dhe te komunikimit kolektiv me bashkesi te tjera.

Per kete arsye pejsazhi eshte nje element vendimtar ne imazhin qe nje bashkesi ofron jashte vetes se saj dhe ne te njejten kohe deshmon shkallen e qyteterimit dhe aftesine e mirepritjes se saj.

Pejsazhi paraqet nje pasuri qe duhet vleresuar per zhvillimin e shkembimeve ekonomike midis bashkesive: eshte elementi kryesor per terheqjen e turisteve, u jep vlere materiale dhe jomateriale prodhimeve te agrikultures, eshte mjet i paraqitjes se prodhimeve artizanale, te manifaktures dhe te te gjitha veprave te gjenise se nje bashkesie.

Nje pasuri strategjike

Pejsazhi eshte nje pasuri themelore qe garanton interesin e pergjithshem te nje bashkesie. Meqenese ambienti perben nje element konstant ne kohen dhe ne historine i cili percakton karakterin, zakonet dhe kostumet e nje populli, pejsazhi eshte nje element themelor i cili ben qe banoret te njohin vetveten si bashkesi.

Kete e deshmojne dhe karakteristikat e pejsazhit te cilat jane frutet e punes se njeriut.

Pejsazhi duke qene nje faktor themelor per njohjen e identitetit te nje bashkesie eshte nje pasuri e pamohueshme e saj. Ai i sherben bashkesise qe te perballoje shkembimet me bashkesite e tjera ne bote ne nje periudhe e cila gjithmone e me teper po karakterizohet nga globalizmi.

Per t'ia arritur ketij qellimi me instrumente te nevojshme te cilat duhet te jene te garantuara gjate kohes eshte e rendesishme qe bashkesia te preokupohet per krijimin e mundesive te zhvillimit lokal. Ky zhvillim duhet te jete i gjere, i perkrahur nga te gjithet dhe duhet te bazohet ne nje perdorim krijues dhe jetegjate te pasurive ne territorin perkates me qellim qe te garantohet prania dhe riperteritja e tyre per brezat e tanishem dhe ato qe do te vijne.

Fjalet thelbesore:

burim, identitet, zhvillim lokal, globalizim, mbeshtetje.

1.2 PEJSAZHI SI SHPREHJE E TERRITORIT

Si eshte e mundur qe nje bashkesi te njohet vetveten ne nje pejsazh dhe qe ky pejsazh te arrije t'ju komunikojte te tjereve ekzistencen e kesaj bashkesie?

Ne cilen menyre nje territor komunikon identitetin e tij?

Ne mes te gjithet percaktimeve qe mund ti behen nje pejsazhi ai qe i pergjigjet me shume kesaj pyetjeje eshte pejsazhi si "shprehje e territorit".

Pejsazhi si shprehje eshte i perbere nga nje bashkesi shenjash dhe elementesh qe perceptohen pavaresisht nga origjina dhe nga shkaku. Jane elemente e shenja te pejsazhit komponentet e tij naturale, shenjat e ndryshimit qe njeriu ka bere gjate koherave, transformimet bashkekohore, zakonet dhe shenjat jo te perkohshme ne momentin ne te cilen keto jane krijuar (lulezimi, nje fushe me grure ose nje fushe qe sapo eshte punuar, prania e plehrave, decori ose shkaterrimi i nje ndertese, etj).

Duke e konsiderua pejsazhin si nje shprehje, ky i fundit mund te kete nivele te ndryshme komunikimi ne funksion te instrumenteve me te cilat mendja e secilit prej nesh interpreton dhe lidh shenjat ndermjet tyre. Eshte e qarte qe nje gjeolog mund te vleresoje ne menyre te ndryshme nje pejsazh malor ose nje agronom mund te vleresoje ose te provoje ngurrim perballe nje pejsazhi bujqesor qe nuk ka vlere ose eshte i shkaterruar. Ne te njejten menyre mund te vleresohet nje pejsazh sepse na kujton dike apo diçka ose ne te kunderten na tregon diçka qe nuk e kishim pare me pare. Megjithate ekziston gjithmone nje komunikim i hapur i pejsazhit qe eshte i perbashket per te gjithë dhe qe u lejon te gjithëve te kene perceptimin e shenjave qe karakterizojne nje territor.

Koncepti i pejsazhit si nje shprehje e territorit, megjithese i pare ne menyre subjektive, eshte ne themel te vleres universale, eshte nje element i rendesishem analize dhe projekti per te percaktuar politiken, planet, nderhyrjet qe duhen bere per mbrojtjen dhe promovimin e cilesise se tij qe keto te fundit te mund te perceptohen dhe qe mund te komunikojne vlere popullore se territorit.

Fjale thelbeshore:

Shprehje, shenja, komunikim, universal, subjektivitet, analiza dhe projekti i pejsazhit.

1.3 PEJSAZHI SI PRODHIM I BASHKEPUNIMIT TE NJERIUT ME AMBIENTIN

Pejsazhi, si bashkesi e komponenteve qe e perbejne dhe e shenjave qe ne perceptojme, eshte i kushtezuar nga disa ndryshime ambientale, ne rralle te pare gjeologjia dhe klima (ne te vertete nuk jane te pandryshueshem duke pasur parasysh nje periudhe me te gjate) dhe fenomenet e medha biotike dhe jo biotike me to te lidhura, te cilat percaktojne karakterin e shume komponenteve dhe disiplinat me te cilat ne klasifikojme boten natyrore (botanika, zoologjia, idrologjia, idrogeologjia etj).

Njeriu, duke qene pjese e botes natyrore dhe komponent i nje niveli tjetër që bashkepunon me të, ka zhvilluar kapacitet të simbiozitet me territorin dhe në vazhdim të ndryshimit të territorit gjithmone e me teper gjate kohera ka realizuar shume vepra e ka zhvilluar shume teknika të drejtimit që karakterizojne territorin dhe perdorimin e terrenit.

Keto ndryshime dhe menytrat e peredorimit të territorit bazohen në pergjithesi në perdorimin e pasurive dhe karakteristikave të ambientit.

Pejsazhi që në perceptojme është kështu një prodhim i karakteristikave natyrore dhe e bashkepunimit të njeriut me ambientin.

Fjale thelbesore:

Natyra, ambienti, invarianti, simbiozi, bashkepunim, transformim, drejtim, perdorim i terrenit.

1.4 PEJSAZHI SI NJE PASURI PUBLIKE

Në se në fillimet e historisë njeriu ka mundur të jetojë me prodhimet që gjente në ambientin natyror, me kalimin e kohës arriti të dallohej nga bota natyrore duke zhvilluar një kapacitet për transformimin dhe drejtimin e territorit të tillë që bëri të mundur që ai të arrinte të ndërtonte një ambient me jete të re.

Kapaciteti i drejtimit dhe i transformimit gjatë kohës u zhvillua dhe u përhap, sidomos pas revolucionit industrial i cili i dha atij një shtytje progresive. Zhvillimi i teknologjive ka krijuar mundësinë e përqendrimit në disa subjekte, edhe pse keto mund të jenë pjesëtar të komuniteteve të largëta, të një kapaciteti të madh transformimi.

Keto rrethana kanë sjellur rritjen e rrezikut të perdorimit të madh dhe jo të barabartë të pasurive natyrore. Përpara këtyre rreziqeve, duke konsideruar ambientin dhe territorin si një pasuri strategjike kolektive, komuniteti duhet të mendojë që të arrijë të ardhura pa shkatërruar kapitalin fillimtar dhe të përkahe shpërndarjen e barabartë të përfitimeve dhe jo përfitimeve që rrjedhin nga ky

perdorim. Si burim i nje bashkesie qe duhet tju trashegohet brezave te ardhshem ambienti mund te percaktohet dhe si kapital fiks shoqeror.

Ky perkufizim duket se kundershohet ne nje ane nga mundesia e nje perdorimi eskuziv i percaktuar nga te drejtat private qe nje subjekt ose nje grup subjektsh mund te ushtrojne ne drejtim te bashkesise. Vete koncepti i pasurise private te tregon nga ana etimologjike dhe historike ndalimin e perdorimit te pasurise ne menyre kolektive.

Cili eshte elementi qe vazhdon ta beje territorin edhe kur eshte prone private nje faktore me vlere te perbashket dhe nje identitet te mundshem per komunitetin? Ne cilen menyre une mund te perdor nje prone private edhe pse nuk jam pronari?

Perceptimi i pejsazhit eshte nje nga format themelore te perdorimit qe i sjell dobi komunitetit (kur eshte i perceptuar) dhe lejon mundesine e njohjes se tij.

Peisazhi eshte nje shembull i qarte i pasurise publike dhe ekonomike, nje pasuri qe mund te perdoret edhe pa paguar dhe nga i cila nuk mund te ndihesh i perjashtuar. Kjo ndodh edhe kur ekziston prona private e tokave.

Ne te njejten menyre duke pranuar ekzistencen e prones private, duke qene e lidhur kjo e fundit me nje pasuri me interes publik siç eshte pejsazhi, perdorimi dhe transformimi i territorit mund te jete legalisht subjekt i kufizimeve te veçanta,.

Fjale thelbesore:

Ambiente, kapitali fiks social, pasuri publike, prone publike dhe private, interesi publik.

1.5 PEJSAZHI DHE INSTITUCIONET

Mbrojtja institucionale e pejsazhit duke qene nje pasuri e veçante kulturore dhe ambientale me karakter te rralle, si norme origjinen e saj e merr nga nje aksion publik i organizuar nga nivelet me te larta shteterore.

Ky aksion, historikisht, ka shikuar ne fillim vetem dimensionin kulturor duke e konsideruar pejsazhin si nje kuader perceptiv me vlere dhe si i tille ai duhej te ruhej. Ky vleresim eshte frut ne te njejten kohe i nje kompetence me vlere

absolute te konsideruar universale (Estetika e pejsazhit) dhe te nje shikimi pjesor, duke qene se pejsazhi konsiderohet vetem si nje kuader perceptiv dhe jo si skena e jetes se individeve dhe te bashkesise.

Ky vleresim tradicional permban ne vetvete shume te meta:

1. nuk konsideron agjentet dhe kushtet (shoqerore, ekonomike dhe teknike) qe kane percaktuar zhvillimin e kuadrit te pejsazhit;
2. realizon ne te njejtin moment te vendosjes se masave paraprake te mbrojtjes (kusht administrativ) nje heqje (efektive ose e perceptuar si e tille) te nje pjese te territorit nga perdorimi i lire i bashkesise lokale;
3. realizon dhe komunikon nje kujdes per pejsazhin i kufizuar ky vetem per vende te veçanta dhe jo per te gjitha territorin, si skena e jetes se popullsise.

Me konsolidimin dhe rritjen progresive te institucioneve demokratike çdo organizate shteterore degezohet dhe behet me komplekse, si ne menyre horizontale ne lidhje me organizimin ne sektore (ministri, institute kombetare etj) ashtu dhe ne menyre vertikale nga niveli kombetar ne ate rrethimor dhe lokal.

Ne mungese te nje bashkepunimi te pershtatshem institucional dhe te integritit te sektoreve te nderhyrjes, ky kompleksitet i madh mund ta beje me te veshtire dhe me pak efikas aksionin jo vetem per mbrojtjen e kuadrit te veçante te pejsazhit por edhe te percaktimit te ngritjes se nivelit cilesor te pejsazhit te perhapur qe perben vendin e jeteses se bashkesise.

Per nje politike efikase te pejsazhit si per zonat e veçanta ashtu dhe per te gjitha territorin eshte e nevojshme nje perkufizim i kompetencave qe permbajne nevojën e integritit midis politikave te ndryshme sektoriale (nga planifikimi territorial i bujqesise, ne ate te ambientit, te turizmit, te infrastruktures) dhe te bashkepunimit dhe te koordinimit midis niveleve te ndryshme shteterore.

Perkufizimi i kompetencave dhe i menyrave te integritit te politikave dhe te kooperimit midis instituteve duhet te perpunohet ne baze te kushtit specifik istitucional dhe administrativ te secilit realitet kombetar.

Fjale thelbesore:

ruajtje, kuader perceptiv, skena e jetes, bashkesi, institucion, kompetence, integrim.

1.6 PEJSAZHI PJESEMARRES

Elementi pjesemarrës për mbrojtjen, promovimin dhe drejtimin e pejsazhit përbën një nga çështjet për kapërcimin e politikave të pejsazhit të bazuara në mekanizmin komandë kontroll: të vendosësh një kufizim, të përcaktosh rregullat që duhen respektuar, të kontrollosh zbatimin e tyre dhe të ndalosh abuzimet eventuale.

Megjithatë, nga ana teorike, ky koncept i komandës e kontrollit, i lindur në periudhat ku raportet midis institutëve dhe shoqërisë civile ishin të shprehura nga një shpirt autoriteti dhe nga një detyrim represiv i organizmit shtetëror, mendohej pak a shumë të ishte i kapërcyesh por faktikisht kapërcimi i tij jo vetëm që nuk është arritur por gjithashtu nuk është edhe aq e lehtë që të arrihet. Në realitet ky objektiv shikon vetëm në vitet e fundit zbatimin e eksperimenteve të para me sukses.

Tema e pjesëmarrjes është bërë një nga pikat qendrore në refleksionet e politikave të pejsazhit dhe përbën një nga detyrat themelore të Konventës Evropiane për pejsazhin. Konventën përshkruan hapjen e “procedurave të pjesëmarrjes së publikut, të autoriteteve lokale e rrethore dhe të subjekteve të tjera të cilat janë të thirrur për të marrë pjesë në përkufizimin e politikave mbi pejsazhin”.

Ky proces duhet të jetë i shoqëruar, dhe ai vete përbën një moment themelor, nga aksione të cilat synojnë të forcojnë gjithmone e më tepër bindjen mbi suksesin e pejsazhit; nga një aksion edukimi për rritjen e pjesëmarrjes të njohjes dhe të ndjeshmërisë për ambientin.

Për të realizuar një proces pjesëmarrës me efikasitet është e nevojshme t’ju drejtohesh jo vetëm komuniteteve lokale si bashkësi qytetëresh, por edhe formave të paraqitjes institucionale dhe jo institucionale të interesave, të nevojave dhe të pikave të shikimit të kategorive specifike të shoqërisë civile të

cilet relacionohen me shume qofte si perdorues aktiv dhe pasiv me temen e pejsazhit (stakeholder).

1.7 POLITIKA KRIJUESE DHE E INTEGRUAR

Kapercimi i mekanizmit te komandes e kontrollit kerkon ekserimentimin e menyrove te

pjesemarrjas te subjekteve social dhe ekonomik qe percaktojne trnsformimin dhe drejtimin e pejsazhit. Jane keshtu te nevojshme politika krijuese per mbrojtjen dhe per promocionin e cilesise se pejsazhit. Keto politika jane krijuese jo sepse jane pa themele reale, por sepse bashkojne dhe integrojne ne te njeitin projekt nje numer faktoresh dhe aktivitetesh te bazuara mbi vlera (ekonomike, teknike, kulturore, normnative) reale qe jane te afta te prodhojne efekte pozitive mbi pejsazhin. Keto politika krijuese jane ne disa raste te eksperimentuara (p.sh. agriturizmi qe bashkon aktivitetin e drejtimit te pejsazhit bujqesor me aktivitetin turistik) ne raste te tjera jane bere hipoteza teorike por akoma duhen vleresuar faktikisht. Vazhdimesia e evolucionit ekonomik, teknik te nevojave materiale dhe jo materiale qe shpreh shoqeria kerkon dhe i jep vlere kapacitetit per te ndjekur interesin publik ne menyre krijuese, me pjesemarrjen ne kete menyre te shoqerise civile dhe te ndermarrjeve.

Fjale thelbesore:

pjesemarrje, krijimtari, konkretizim, interes publik, shoqeri civile, ndermarrje.

1.8 TEKNIKAT DHE NIVELET E PLANIFIKIMIT

Edhe pse mjetet e planifikimit dhe te projektimit te pejsazhit ne shume raste kane dhene rezultate te ndryshme, disa here te sukseshme, disa here mediokre, e disa here te pamjaftueshme, nuk eshte e mundur absolutisht te pranohet se nje teknike apo nje nivel planifikimi eshte me i mire apo me efikas se nje tjeter.

Ne fakt janë vendimtare dhe shumë faktor të tjerë, pavarësisht nga mudezia e një plani “ të bërë mirë”:

fuqia e administratës që zbaton planin ose projektin, përfaqësia midis përmbajtjes së planit ose projektit dhe orientimet e shoqërisë civile, bashkësia ekonomike, sociale dhe demografike, aksionet për shoqërimin e planit (informacion, formacion, shtytje, asistencë), niveli i përgatitjes së teknikeve dhe të profesionistëve, mbështetja e opinionit publik lokal.

Duke parë që kushtet që vendosin mbi suksesin apo dështimin e një plani janë të shumta, mund të përkohet se një plan “i bërë mirë” duhet të karakterizohet nga :

- objektivat e përgjithshme të përkufizuara dhe të ndara (dimensioni strategjik)
- përkufizimi teknik i qartë dhe i verifikueshëm i elementeve me vlerë, i rregullave dhe i çelësive që garanton transformimin e territorit (dimensioni teknik)
- mundësia për studime dhe baza informative (dimensioni shkencor dhe kultural)

Një plan i bërë mirë duhet të garantojë:

- një fleksibilitet të arsyeshëm për zbatim pa rrezikuar në këto mënyra objektivat e përgjithshme apo të veçanta të parashikuara (dimensioni i përshatshmerisë)
- mundësinë e kontrollit të nivelit të çelësive nëpërmjet momenteve të verifikimit të formalizuar dhe periodik, mbi baze të elementeve gjykesive të sasive dhe çelësive të cilët luajnë rolin e treguesve të kontrollit (dimensioni i vlerësimit)
- veçoritë e përmbajtjes përballë kompetencave dhe kapacitetit që lidhen dhe integrohen në mënyra ndihmëse me subjektet e tjerë institucionale (dimensioni institucional)

Ne veçanti plani i pejsazhit duhet te kerkoje:

- integrimin me planet, programet, financimet qe influencojne ne transformimin e territorit ne menyre qe te realizoje objektivat e veta (dimensioni intersektorial).

Fjalet thelbësore:

strategji, teknik, shkence dhe kulture, fleksibilitet, kontroll, tregues, vleresim, ndihme, integrim.

1.9 PROJEKTI I PEJSAZHIT PER TERRITORIN

Si ne fushen arkitektonike ashtu edhe ne ate artistike eshte treguar me kohe qe ruajtja e veprave te artit kerkon nje nderhyrje aktive ne te cilen jane te percaktuara gustet dhe kultura e subjektit qe nderhyn. Domethene mbrojtja dhe restaurimi jane ne fakt nje projekt dhe nuk ekziston as ne menyre teorike dhe as ne menyre praktike mundesia per te ndaluar kohen qe rrjedh dhe transformimin e lendes se vepres qe duhet ruajtur. Edhe eliminimi i shenjave te vjetersise mbi siperfaqen e nje piktore apo te nje basorilievi (patina) ose ruajtja e tyre kane qene ne historine e restaurimit subjekt i shume debateve. Kjo tregon qe nuk ekziston restaurimi thjesht i objektit, por restaurimi eshte ne rradhe te pare nje projekt ku subjekti qe ben restaurimin nderhyn mbi nje sere elementesh te dhene, duke kerkuar te vleresoje (sipas kultures se kohes dhe te tij) karakteristikat thelbësore. Ne se kjo gje eshte e vertete per piktoren apo per skulpturen , qe mund te vendosen ne ambiente te mbyllura duke penguar ne kete menyre aksionet e agjenteve te jashtem, atehere eshte e vertete dhe ne permasa me te medha neqoftese do konsiderojme pejsazhin. Kur i referohemi territorit, duket qarte qe komponentet qe percaktojne cilesine jane komplekse dhe dinamike. Karakteristikat cilesore te nje territori jane gjithmone rezultati i ndryshimeve te ndodhura gjate nje harku kohe, qofte persa i perket kohes gjeologjike, qofte persa i perket kohes historike, ndryshime te shkaktura nga procese naturore apo nga veprat e njeriut. Pejsazhi normalisht eshte i perbere

edhe nga komponentet biologjik (e qarte qe nuk flitet per pejsazhe henore) qe edhe keto jane objekt i ndyshimeve te vazhdueshme dhe ciklike (stinore). Pejsazhi ndryshon vazhdimisht. Ne se duam te ruajme nje strukture te dhene te territorit duhet te nderhyjme shpesh ne menyre aktive. Ne se per shembull konfermojme vleren e nje pejsazhi te perbere nga pyje dhe lendina te lulezuara dhe duam te ruajme kete perberje si nje "kuader peisazhi" eshte e nevojshme te nderhyhet me forma administrimi aktive. Ne rast te kundert pylli fillon te pushtoje lendinen duke eleminuar ne kete menyre ate element me vlere (intervalin midis pyllit dhe lendines se lulezuar) qe lejon pranine e lendines dhe ndalon formimin e pyllit.

Atehere mund te themi se realizojme nje projekt jo vetem kur modifikojme ambientin dhe projektojme nje pejsazh te ri, ose kur nderhyjme per restaurimin e nje pejsazhi te ri duke i ridhene cilesite e humbura (per shembull kur ndertojme nje radhe pemesh apo shembim nje ndertim qe shemton kete kuader te pejsazhit), por edhe kur duam te mbajme ose te ruajme nje pejsazh ekzistues.

Domethene ruajtja, restaurimi, krijimi i peisazheve te reja duhen te konsiderohen si forma te ndryshme projekti per territorin.

Per te projektuar dhe realizuar nje strukture te territorit, nje peisazh, nuk eshte e njejta gje si te projektosh dhe te realizosh nje kuader apo nje skulpture sepse kerkon nje kujdes dhe nje verifikim paraprak te zbatimit.

Normalisht, i ndryshem eshte edhe detyrimi ekonomik. Pastaj eshte e nevojshme qe te sigurosh qe projekti t'i pershtatet rregullave komplekse administrative te urbanistikës.

Projekti duhet te jete kohesor me kontestin territorial dhe social. Duhet me perpara te studiosh territorin per te kuptuar karakteristikat ambientale dhe te njohesh perberjen shtresore historike. Eshte e nevojshme dhe te analizosh raportin ndermjet ketyre karakteristikave dhe bashkise lokale duke kerkuar qe te kuptohen kush jane elementet e territorit ne te cilen komuniteti njeh elemente te identitetit te tij. Duhet pasur parasysh qe pejsazhi mund te ndryshoje ne menyre spontane dhe qe mund te ndryshojne kerkesat e perdorimit te tij ose kerkesat materiale dhe shpirtore te komunitetit. Struktura e propozuar duhet te garantoje

arch. Giovanni Cafiero

nje shkalle fleksibiliteti. Megjithate duhet mbajtur parasysh qe per te realizuar nje strukture territoriale eshte e nevojshme te sigurosh dhe nje drejtim te pershtatshem te territorit, nje drejtim te mundshem nga ana ekonomike, teknike, sociale dhe ambientale dhe te garantosh ne te njejten kohe dhe ruajtjen per brezat e ardhshem te burimeve te parikthyeshme.

Fjale thelbesore:

projekt, zbatim, koherenc, ambient, kulture, njohje, fleksibilitet, evolucion, ekonomi ne drejtim, mundesi.